



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:173975

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644551

KPPP.nr. 122/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., me numër të biznesit 70433554, me seli në Gjakovë, kundër debitorit “V.R. - Hangover” me seli në Gjakovë, rruga “Skënderbeu”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 380/23 të datës 21.07.2023, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “V.R. - Hangover”, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 380/23 të datës 21.07.2023, i Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 717.46€ (shtatëqind e shtatëmbëdhjetë euro e dyzetë e gjashtë cent).
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “V.R. – Hangover” dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 380/23 të datës 21.07.2023, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, sa i përket shumës prej 368.47€ (treqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e dyzet e shtatë cent).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., ndaj debitorit “V.R. – Hangover”, sipas urdhrit përmbartimor P.nr. 380/23 të datës 21.07.2023, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi, për shumën prej 717.46€ (shtatëqind e shtatëmbëdhjetë euro e dyzetë e gjashtë cent).

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Gjakova” SH.A., ka lëshuar Urdhrit Përmbaresimor P.nr. 380/23 të datës 21.07.2023 duke lejuar përmbaresimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit të datës 17.07.2023 me shifër 039602, për periudhën 01.09.2017 deri me 01.07.2023, me të cilin e ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 1,085.93€ (njëmijë dhe tetëdhjetë e pesë euro dhe nëntëdhjetë tre cent) duke llogaritur edhe kamatën 8% në vit nga dita e pranimit të urdhrit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogari të veçantë bankare të përmbaresit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbaresimore të zbatojë përmbaresimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se Përmbaresi Privat ka lejuar përmbaresimin e propozuar nga ana e kreditorit të borxhit i cili sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, respektivisht neni 360 pika 1.1 ka arritur afatin një vjeçar të parashkrimit, ngase sipas nenit të lartcekur e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar çdo muaj parashkruhet afati prej 1 viti. Pra, duke qenë se urdhri i lartcekur përmbaresimor është lëshuar në bazë të Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit të datës 17.07.2023 me shifër 039602, për periudhën 01.09.2017 deri me 01.07.2023 të një borxhi që LMD e konsideron si borxh të parashkruar, dhe se konform nenit 360 të njëjtë Ligj, e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar çdo muaj parashkruhet afati prej 1 viti. Tutje ka shtuar që sipas Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit të datës 17.07.2023 me shifër 039602, borxhi është përcaktuar nga viti 2015 deri në vitin 2023 duke theksuar se debitori e ka lëshuar objektin në vitin 2020 dhe faturimi i muajit Qershor 2023 nuk i përket debitorit sepse në këtë periudhë sasia e ujit për këtë muaj nuk është shpenzuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të abrogohen veprimet e kësaj procedure përmbaresimore dhe urdhri i lartcekur përmbaresimor të hedhet poshtë si i pabazuar.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, duke theksuar se pretendimet e debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit e të cilat i ka theksuar në prapësim, nuk qëndron pasi që debitori ka pranuar borxhin dhe neni 368 të LMD-së par. 1 përcakton se “1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.” Tutje ka shtuar se pranimi i borxhit vërtetohet nga pagesat e kësteve

që ka bërë debitori dhe ka pretenduar se kërkesat parashkruhen pas 5 viteve. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr. 039602 – Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.039602, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.039602, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37

të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në kopje të verifikuar.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të ekstraktit nga librat afarist për faturat e përfshira në ekstrakt dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat nga data 01.09.2017 deri me datën 01.07.2020 në shumën prej 717.46€, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 21.07.2023, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit për faturat nga data 01.09.2017 deri me datën 01.07.2020, është parashkruar, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe për shumën prej 717.46€, e anuloi urdhrin për përmbarim P.nr.380/23 të datës 21.07.2023, të Përmbaruesit Privat Gjikë Radi, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore 01.08.2020 gjerë me datë 01.07.2023, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 01.08.2020 deri më datë 01.07.2023, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 21.07.2023, ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.380/23 të datës 21.07.2023, të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, për shumën prej 368.47€, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar.

Ndërsa sa i përket pagesës të bërë me datë 14.08.2020, gjykata duke u bazuar në nenin 293 par.2 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”*, të njëjtat i llogariti si pagesa për shumën para periudhës së datës 01.08.2020, në përputhje me dispozitën e lartcekur.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.122/24, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.